

Paketa e dytë e Rezistencës Sociale mbështet grupet në nevojë



Përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara janë ndër kategoritë që përfitojnë nga Paketa e dytë e Rezistencës Sociale për grupet në nevojë. 64 mijë familje do të mbështeten duke filluar nga 1 Tetori me 10% të rritjes së masës së ndihmës ekonomike. Dyfishohet masa e ndihmës ekonomike për gratë kryefamiljare me dy fëmijë dhe për të moshuarit mbi 65 vjeç, për të moshuarit e vetmuar, për të moshuarit pa pension pleqërie, për të moshuarit pa pension social. Indeksjojmë masën për pagesat e personave me aftësi të kufizuara 7.5%. Kemi vendosur që të mbështesim kategorinë e personave të cilët janë të verbër, paraplegjikë dhe tetraplegjikë me status, duke i garantuar edhe rritjen e mbështetjes për energjinë elektrike.



HAPET SPITALI I RI I LAÇIT

Ditën e Shenjtërit të Nënë Terezës hapi dyert spitali i ri i Laçit, i rindërtuar nga themelet pas dëmtimit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, një investim i qeverisë shqiptare. Spitali i ri i Laçit i rindërtuar nga themelet është pajisur me aparatura mjekësore të teknologjisë së avancuar. Ka një kapacitet prej 40 shtretërish dhe do të ofrojë shërbimet e urgjencës; të imazherisë; laboratorit; kirurgjisë; patologjisë; maternitetin dhe pediatriinë; fizioterapinë, etj.



29 FËMIJË PËRFITUAN FALAS NGA PAKETA E IMPLANTIT KOKLEAR

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ka vizituar fëmijët me humbje të thellë dëgjimi, të cilët i janë nënshtruar ndërhyrjes së implantit koklear në Spitalin Francez në QSUT. Manastirliu u shpreh se kjo është një ndërhyrje që ofrohet falas nga shteti.

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shpreh se Programi ynë i dëgjimit do të vijojë të fuqizohet në maternitetet në të gjithë vendin. Ky është viti i tretë i financimit 100% nga shteti i implantit koklear, një paketë që garantohet falas për çdo fëmijë me humbje të thellë dëgjimi.

INVESTIMI NË SPITALIN INFEKTIV, DO TRANSFORMOHET NË QENDËR EKSELENCE

Kryeministri Edi Rama dhe Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu kanë inspektuar punimet në Spitalin Infektiv, i cili pritet të përfundojë së shpejti rehabilitimin dhe zgjerimin, për t'u kthyer në një qendër ekselence për sëmundjet infektive. Investimi për rindërtimin e Spitalit Infektiv vjen në kuadër të planit të qeverisë për përballimin e emergjencave shëndetësore, me fuqizimin e kapaciteteve në sistemin spitalor si dhe Planin e Masave 2021-2022 për përgjigjen ndaj pandemisë Covid-19.



PLAN MASASH PËR LUFTËN NDAJ ANTIBIOTIKO-REZISTENCËS

"Plan kombëtar masash për antibiotiko-rezistencën dhe zero tolerancë për dhënien pa kriter të antibiotikëve". Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale Ogerta Manastirliu gjatë një takimi të zhvilluar me Komitetin Kombëtar të Ekspertëve për Testimin e Ndjeshmërisë Antimikrobike tha se do të ketë një plan të rifreskuar, duke filluar nga kujdesi parësor deri në shërbimin universitar, me synim uljen e efekteve nga përdorimi i tepërt i antibiotikëve dhe efekteve që vijnë si pasojë e antibiotiko-rezistencës.

